



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Financave

# Raporti fiskal mujor

*Janar - Dhjetor 2011*

**Janar, 2012**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TREGUESIT FISKALË PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2011 .....</b>	<b>2</b>
<b>ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2011 .....</b>	<b>2</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm .....</b>	<b>2</b>
<b>Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera .....</b>	<b>4</b>
<b>Taksimi i konsumit (indirekt) .....</b>	<b>4</b>
<b>Taksimi direkt .....</b>	<b>6</b>
<b>ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2011 .....</b>	<b>9</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm .....</b>	<b>9</b>
<b>Shpenzimet Korrente .....</b>	<b>10</b>
Shpenzimet e Personelit .....	10
Shpenzimet për Interesa .....	11
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes .....	11
Shpenzimet për Subvensione .....	12
Shpenzimet për Fonde Speciale .....	12
Shpenzime të Pushtetit Lokal .....	13
Pagesa e Papunësisë .....	13
<b>Shpenzimet Kapitale .....</b>	<b>14</b>

## TREGUESIT FISKALË PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2011

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për vitin 2011, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 330.5 miliardë lekë (shih tabelën 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 4.0 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 1.8 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 376.2 miliardë lekë (shih tabelën), 3.8 përqind më të ulëta së planifikimi dhe 3.7 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 1.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale janë rritur me 4.5 përqind.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 12-mujor në 45.7 miliardë lekë, 1.1 miliardë lekë më pak se planifikimi, dhe 7.7 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Defiçiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 438 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e defiçitit; 28.2 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i defiçitit ka qënë në nivelin 19.7 miliardë lekë, ose 2,912 milionë më shume se planifikimi.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhën Janar-Dhjetor

Miliardë lekë	Janar - Dhjetor '10	Janar - Dhjetor '11	Planifikimi 2011
TË ARDHURAT TOTALE	324.7	<b>330.5</b>	344.0
SHPENZIMET TOTALE <i>nga te cilat:</i>	362.8	<b>376.2</b>	390.9
SHPENZIMET KORRENTE	300.9	<b>305.6</b>	311.5
SHPENZIMET KAPITALE	67.5	<b>70.6</b>	73.7
BALANCA FISKALE	-38.0	<b>-45.7</b>	-46.8
BALANCA PRIMARE	3.6	<b>-4.6</b>	0.0

## ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2011

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore arritën në 330.5 miliardë lekë, 4 përqind më pak se parashikimi në buxhetin e rishikuar për vitin 2011 dhe 1.8 përqind më shumë se një vit më parë duke shënuar rritjen më të ulët në pesë vitet e fundit.

EMËRTIMI	12M-2007	12M-2008	12M-2009	12M-2010	12M-2011
TOTALI TE ARDHURAVE (mln lekë)	251,555	291,238	298,981	324,721	<b>330,450</b>
Rritja vjetore	9.6	15.8	2.7	8.6	<b>1.8</b>

12 – MUJORI			
	E M E R T I M I	STRUKTURA	
		2010	2011
<b>II.</b>	<b>TË ARDHURAT TATIMORE GJITHSEJ</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>77.3%</b>	<b>77.5%</b>
1	T.V.SH.	51.1%	50.6%
2	Akciza	7.9%	8.4%
3	Tatimi mbi Fitimin	17.4%	17.2%
4	Të Ardhura Personale	12.1%	11.9%
5	Taksat Nacionale dhe tjera	8.2%	9.1%
6	Taksa e Doganore	3.3%	2.9%
<b>II.2</b>	<b>Të ardhurat nga Pushteti Vendor</b>	<b>4.1%</b>	<b>3.9%</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhurat nga Fondet Speciale</b>	<b>18.6%</b>	<b>18.6%</b>

vitet 2011 dhe me ulje vjetore prej 0.9 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 56.6 miliardë lekë nga rreth 58 miliardë lekë të planifikuara, kundrejt 53.6 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 5.6 përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 3.8 miliardë lekë, nga rreth 4.6 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 22.7 miliardë lekë nga 31.6 miliardë të një viti më parë, me rënie vjetore -28 përqind dhe realizim të planit të rishikuar prej 112.4 përqind.

#### Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur rreth 128.1 miliardë lekë 1.3

Dogana total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	8.1	-34.3	13.4
Shkurt	8.2	1.3	9.9
Mars	9.5	15.9	-3.4
Prill	9.4	-1.1	-3.6
Maj	9.9	5.3	-4.8
Qershor	11.1	12.1	8
Korrik	11	-0.9	2.3
Gusht	13.3	20.9	17.6
Shtator	10.2	-23.3	-1.9
Tetor	11.2	9.8	18.4
Nentor	11.6	3.6	15.5
Dhjetor	14.6	25.9	18.3

parë të vitit 2010. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej -1 përqind, kundrejt një viti më parë. Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë 9.6 përqind më të larta se një vit më parë dhe 3.4 përqind më shumë se parashikimi për periudhën sipas buxhetit të rishikuar.

#### Pesha specifike e çdo tatimi ne Totalin e te Ardhurave Tatimore

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 97.3 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 6.6 miliardë lekë më pak se parashikimi, dhe 5.6 përqind më shumë se një vit më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 11.8 miliardë lekë nga 15.3 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar të

parashikimi në buxhetin e rishikuar për 2011, dhe me rritje 7.5 përqind kundrejt vitit 2010. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentës minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 63.7 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore si dhe ndryshimeve në normën e taksimit dhe në strukturën e taksës gjatë gjysmës së

Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2010 (pa kontributet)

Tatime Total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	9.0	-2.8	7.0
Shkurt	7.8	-13.9	8.4
Mars	10.7	37.6	17.0
Prill	7.7	-28.0	-4.1
Maj	9.2	19.4	15.8
Qershor	8.0	-12.4	-2.6
Korrik	8.7	7.9	-1.2
Gusht	8.4	-3.4	-11.9
Shtator	9.0	6.9	-10.6
Tetor	9.0	0.0	0.4
Nentor	9.0	0.0	9.0
Dhjetor	10.8	2.0	17.0

miliardë lekë më shumë të ardhura se viti 2010, ose 6.8 (përfshirë dhe kontributet) për një total prej 158.8 miliardë. Totali i të ardhurave nga administrata tatimore ka pasur një rritje prej 3.4 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 6.8 përqind mbi baza vjetore. Administrata tatimore ka rezultate të mira në mbledhjen e tatim fitimit, akcizës dhe taksave nacionale për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë, ndërsa TVSH-ja ka pasur një rënie prej -10.1 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**TË ARDHURAT SIPAS TAKSAVE, TATIMEVE DHE BURIMEVE TË TJERA****TAKSIMI I KONSUMIT (INDIREKT)**

Nga TVSH-ja janë mbledhur gjithsej për 12-mujorin 119.2 miliardë lekë, ose 4.6 përqind më shumë se një vit më parë dhe -0.7 përqind më pak se parashikimi në buxhetin e rishikuar për vitin 2011.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në vite për 12-mujorin

EMERTIMI	2009	2010	2011
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Total (milion leke)	110,062	113,998	<b>119,189</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Total (rritja vjetore ne %)	2.8	3.6	<b>4.6</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Dogana (milion leke)	77,370	84,798	<b>92,925</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Dogana (rritja vjetore ne %)	3.3	9.6	<b>9.6</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Tatime (milion leke)	32,692	29,200	<b>26,263</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Tatime (rritja vjetore ne %)	1.7	-10.6	<b>-13</b>

**Nga administrata doganore** janë mbledhur 92.9 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës në masën 103.4 përqind. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 8.1 miliardë lekë më shumë, ose 9.6 përqind më shumë. Për muajin dhjetor TVSH-ja në doganë ka një realizim prej 1.2 miliardë lekë më shumë, ose 12.9 përqind më shumë se parashikimi.

Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i këmbimit).

**Nga administrata tatimore** për periudhën Janar – Dhjetor janë mbledhur 26.3 miliardë lekë TVSH nga 30.2 miliardë lekë të planifikuara sipas buxhetit të rishikuar 2011, që do të thotë 13 përqind më pak se parashikimi dhe 10.1 përqind më pak se një vit më parë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 22 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 12-mujore ka arritur shifren 6.5 miliardë lekë nga 6.0 miliardë që ishte një vit më parë, me rritje 8.6 përqind.

Miliardë lekë	2010	2011	Në % ndaj 2010
TVSH e arkëtuar (bruto)	120.0	125.7	4.8
TVSH neto	114.0	119.2	4.6
Rimbursimi faktik i paguar	6.0	6.5	8.6

Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re rënia e peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 28 përqind në vitin 2010 në 24 përqind në vitin 2011.

### Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën janar - dhjetor arritën në rreth 40.4 miliardë lekë; ose -2.1 % me pak se parashikimi sipas planit në buxhetin e rishikuar; krahasuar me vitin 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur në masën 4.2 përqind. Akciza pësoi ndryshime të ndjeshme në Qershor të vitit 2010: u ul akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lekë në 30 lekë për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli “naftë virgin” me nivel akcize 50 lekë për litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Në fillim të vitit 2011 pati rritje të akcizës mbi cigaren, nga 50 lekë në 70 lekë për paketë. Ndërsa ndryshimi më i fundit lidhet me ndryshimin e akcizës për disa mallra si birra, solar mazut dhe koks naftë.

Të ardhurat nga akciza që mbledhin Doganat kanë një rënie me 1 përqind kundrejt një viti më parë dhe 2.4 përqind më pak se parashikimi për periudhën. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si edhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (siç janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon:

- Sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën janar - dhjetor 2011 është 457.3 mijë ton, me rënie vjetore 6 përqind.
- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën janar – dhjetor 2011 është 2,249 ton, me rënie vjetore prej -28 përqind.
- Sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën janar – dhjetor 2011 është 31.4 milionë litra, me një rënie prej 7 përqind;
- Kafeja e zhdoganuar për periudhën 12-mujore ka qënë 3 përqind më shume se e njëjta periudhë e një viti më parë;

Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta pasqyrohen në tabelën më poshtë:

EMERTIMI	2008	2009	2010	2011
Karburantet (ton)	432,448	432,131	484,390	<b>457,297</b>
Ndryshimi ne %	4.2%	-0.1%	12.1%	<b>-5.6%</b>
Birre (000 litra)	33,182	36,601	33,944	<b>31,447</b>
Ndryshimi ne %	10.7%	10.3%	-7.3%	<b>-7.4%</b>
Cigare (ton)	4,238	4,064	4,500	<b>3,249</b>
Ndryshimi ne %	22.3%	-4.1%	10.7%	<b>-27.8%</b>
Kafe (ton)	6,600	6,913	6,335	<b>6,546</b>
Ndryshimi ne %	4.4%	4.7%	-8.4%	<b>3.3%</b>

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 15.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 13.3 përqind dhe realizim të planit të rishikuar në masën 98.4 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e të ardhurave nga akciza në vite dhe sipas agjencive të mbledhjes (doganë/tatime).

Të ardhurat nga akciza 2009 – 2011

	2009	2010	2011
Akciza gjithsej (mld lekë)	33.5	38.8	<b>40.4</b>
Ndryshimi vjetor (%)	3.1	15.8	<b>4.2</b>
Dogane (mld lekë)	20.2	24.8	<b>24.6</b>
Tatime (mld lekë)	13.3	14.0	<b>15.8</b>

## TAKSIMI DIREKT

### Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 28 miliardë lekë për vitin 2011, me rritje 3.4 përqind në krahasim me vitin paraardhës dhe me realizim të planit të rishikuar për vitin 2011 në masën 94.8 përqind. Sipas komponenteve të këtij tatimi, situata e të ardhurave të mbledhura këtë vit dhe krahasimi me 2010 jepet në tabelën më poshtë.

Të ardhura, miliardë lekë	12 mujor 2010	12 mujor 2011	Ndryshimi %
<b>Tatimi mbi te ardhurat personale gjithsej</b>	<b>27.1</b>	<b>27.9</b>	<b>3.4</b>
Paga sektori publik	8.4	8.8	4.2
Paga sektori jo publik	8.0	8.9	11.5
Interesa	3.0	3.2	4.6
Dividendë	1.3	1.4	9.3
Shitje pasuri e paluajtshme	2.4	1.2	-49.3
Te tjera	3.9	4.4	11.4

### Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2011 arritën në rreth 19.7 miliardë lekë nga 17.6 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 12 përqind, dhe -6.7 % me pak se plani i rishikuar.

Tatim fitimi 2011	Muaji (milione leke)	Ne % ndaj muajit paraardhes	Ne % ndaj 2010
Janar	1,302	-22.5	23.9
Shkurt	1,113	-14.5	-10.1
Mars	3,973	257.0	38.9
Prill	1,319	-66.8	10.0
Maj	2,289	73.5	104.1
Qershor	1,316	-42.5	13.0
Korrik	1,237	-6.0	10.2
Gusht	1,413	14.2	-26.0
Shtator	1,314	-7.0	-5.8
Tetor	1,309	0.0	5.9
Nentor	1,458	11.4	-10.4
Dhjetor	1,669	14.5	-0.7

Në rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për këtë vit ka ndikuar derdhja e tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore, e cila krahasuar me një vit më parë është rritur në masën 101.1% ose 1.1 miliardë lekë më shumë. Pësia e tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore në total është vetëm 12%. Përsa i përket sektorit privat të ardhurat nga tatim fitimi janë rritur me vetëm 5.8% duke pasur parasysh që sektori privat zë rreth 88% të peshës specifike në këtë taksë.

Rritjen më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka shënuar sektori i prodhimit me 30.1% e pasuar nga sektori i tregtisë dhe shërbimeve me përkatësisht 25.1% dhe 12.9%. Me ulje janë sektori i ndërtimit dhe ai i transportit me përkatësisht – 20.0% dhe – 11.0 përqind.

Sipas sektorëve kryesore të ekonomisë - situata e tatim fitimit paraqitet në tabelën në vijim.

Emërtimi	12 mujor 2010	12 mujor 2011	Ndryshimi	Subjekte pagues 2010	Subjekte pagues 2011	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>			<i>ne %</i>
<b>Prodhim</b>	3,976,922	5,173,910	30.1	1,986	1,919	-3.4
<b>Ndërtim</b>	3,574,298	2,859,946	-20.0	2,002	1,943	-2.9
<b>Transport</b>	428,668	381,377	11.0	460	459	-0.2
<b>Tregti</b>	3,434,366	4,294,806	25.1	5,268	5,101	-3.2
<b>Shërbime</b>	6,210,350	7,008,802	12.9	1,818	1,935	6.4

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2.6 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 10.9 përqind duke qënë 38.9 përqind më e lartë se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Këtu theksojmë se shifra 2.26 miliardë lekë nuk përfshin edhe vlerën e taksës që nuk është

mbledhur për rimbursimin e çmimit të kasave. Kjo vlerë rimbursimi arrin në rreth 465 milionë lekë, të përbaluara nga fondi i kontingjencës së parashikuar në buxhetin e vitit 2011.

### **Taksimi i pasurisë**

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Është prej kohësh një pjesë problematike e sistemit tatimor, përse i takon të ardhurave të mbledhura kundrejt të ardhurave potenciale që mund të mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i taksës mbi pasurinë rezulton të jetë përgjithësisht efektiv përse i përket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek të njëjtën tendencë në arritjen e nivelit të parashikuar të të ardhurave me taksat dhe tarifatat e tjera të aplikueshme nga njësitë vendore (tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit). Ndërkohë, eksperiencia nuk është e njëjtë për kategorinë “Familjarë” të taksapaguesve. Këtu tendenca në grumbullimin e kësaj takse është e ulët, dhe njësitë e qeverisjes vendore kanë mjaft probleme në administrim dhe në detyrimin për pagimin e taksës. Për nivelin ende të lartë të informalitetit, ka mjaft vështirësi në vlerësimin e bazës së taksueshme, për arsye të mangësive në deklarimin real të pasurive. Për 12-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 1.9 miliardë lekë, nga 10.9 miliardë të parashikuara dhe 2.4 përqind më të larta se një vit më parë.

### **Taksat nacionale**

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 21.4 miliardë lekë nga 22.3 miliardë lekë të parashikuara për periudhën. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 16.9 përqind. Muaji shtator ishte muaji i parë i zbatimit të taksave të reja të hyra në fuqi në fund të gushtit. Ecuria e taksave të reja do të shikohen në vitin 2012.

### **Taksa doganore**

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar – dhjetor 2011 janë rreth 6.9 miliardë lekë, -12.3 përqind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 424 milionë lekë, ose -5.8 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.59 përqind nga 1.74 përqind në vitin 2010, duke kontribuar kështu edhe në uljen e të ardhurave nga taksat doganore.

### **Të ardhura të tjera nga pushteti vendor**

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar - dhjetor arritën në 11.8 miliardë lekë nga 15.3 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin 2011, ndërsa kundrejt 12-mujorit të vitit 2010 të ardhurat janë ulur me 107 milionë lekë (rreth -0.9 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 7.3 miliardë lekë nga 2.5 miliardë të parashikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar këto taksa kanë pësuar një rënie prej -5.3 përqind.

### **Të ardhurat e fondeve speciale**

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën janar - dhjetor 2011 arritën në 56.6 miliardë lekë, me një rritje prej 5.6 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe -2.4 përqind më pak se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 55 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.6 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 48.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 8.4 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 6.2 miliardë lekë, -4.4 përqind më pak se një vit më parë.

Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 12-mujore rezultojnë se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 8.8 përqind, ose rreth 34.2 mijë njësi, kundrejt mesatares 12-mujore të 2010 nga ku sektori i tregtisë dhe shërbimeve zënë pjesën kryesore përkatësisht me rritje 24.1% dhe 7.7%. Në tabelat më poshtë pasqyrohen të dhënat lidhur me numrin mesatar mujor progresiv të kontribuesve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për pjesën që administrojnë administrata tatimore dhe ndarjen e të ardhurave nga kontributet që mbledhin tatimet sipas sektoreve të ekonomisë.



	12-mujor 2010	12-mujor 2011	Ndryshimi ne %
<b>Ndërmarrjet Buxhetore</b>	131,876	139,387	5.7
<b>Ndërmarrjet Shtetërore</b>	21,867	21,712	-0.7
<b>Subjektet Private T.V.SH.</b>	169,547	182,357	7.6
<b>Subjektet Biznes I Vogël</b>	64,916	78,992	21.7
<b>Total</b>	<b>388,206</b>	<b>422,447</b>	<b>8.8</b>

## ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2011

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të vitit 2011, arritën në rreth 376.2 miliardë lekë, nga rreth 390.9 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 96.2 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 14.7 miliardë lekë. Për rrjedhojë këto shpenzime në fund të vitit 2011 përlllogariten në rreth 28.5 përqind e produktit të brendshëm bruto, nga rreth 29.5 përqind që arritën një vit më parë.

Kundrejt vitit 2010, shpenzimet e përgjithshme buxhetore rezultojnë rreth 13.4 miliardë më të larta, ose rreth 3.7 përqind më shumë. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute dhe ritmi i rritjes së tyre në disa vite jepet në grafikun në vijim.




Shpenzimet e kryera nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe kontigjences, janë reflektuar në zerat e shpenzimeve ku ato janë kryer, si më poshtë:

- Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i planifikuar në rreth 1.93 miliardë lekë, gjatë vitit 2011, është përdorur në rreth 1.76 miliardë lekë, përkatësisht rreth 206.2 milionë lekë për shpenzime personeli, rreth 845.6 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 711.7 milionë lekë për investime.
- Fondi i kontigjences për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 3.65 miliardë lekë, gjatë vitit 2011 është përdorur në rreth 2.32 miliardë lekë, nga e cila rreth 1.52 miliardë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore dhe 0.8 miliardë lekë për transfertën e brendshme korrente për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.
- Fondi për rritjen e pensioneve i planifikuar në rreth 1.6 miliardë lekë është përdorur tërësisht në masën e planifikuar dhe është pasqyruar në zërin e shpenzimeve shoqërore, ndërsa nga fondi për rritjen e pagave rreth 604 milionë lekë është përdorur për rritjen e pagave dhe rreth 167.3 milionë lekë për rritjen e sigurimeve shoqërore.

## SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korrente në fund të vitit 2011, kanë arritur në rreth 305.6 miliardë lekë ose rreth





97.1 përqind të planit vjetor me ndryshime (plan që merr në konsideratë përdorimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, nga kontigjenca për rritjen e pagave dhe pensioneve, përdorimet nga fondi i veçantë dhe rishpërndarjet e fondeve brenda dhe ndërmjet

institucioneve buxhetore. Shpenzimet korrente arritën në 23.2 përqind të PBBë nga rreth 24.4 përqind që ishin një vit më parë. Krahasuar me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 4.7 miliardë lekë më të larta ose rreth 1.6 përqind më shumë.

## Shpenzimet e Personelit



Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.1 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, rezultojnë rreth 1.6 përqind nën parashikimin e planit të ndryshuar, rrjedhojë kjo kryesisht e kursimeve në zërin shpenzime për paga, prej rreth 686 milionë lekë, në zërin kontribute për sigurime shoqërore, me rreth 210 milionë dhe në zërin politika të reja pagash me rreth 229 milionë lekë. Shpenzimet e personelit në fund të vitit 2011 arritën në rreth 5.1 përqind e PBBë, nga rreth 5.3 përqind që ishte një vit më parë. Kundrejt një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.7 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.6 përqind më shumë.



Shpenzimet për paga rezultuan rreth 1.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 2.5 përqind më shumë dhe shpenzimet për kontribute të sigurimeve shoqërore rreth 0.2 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.7 përqind më shumë.

### Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 13.4 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, rezultojnë me një kursim kundrejt parashikimit të periudhës, prej rreth 5.7 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 4.4 miliardë lekë në




interesat e brendëshme dhe rreth 1.3 milionë lekë në interesat e jashtme. Në këtë mënyrë shpenzimet për interesa arritën në rreth 3.1 përqind e PBB, nga rreth 3.4 përqind që ishin një vit më parë. Kundrejt vitit të kaluar shpenzimet për interesa rezultojnë rreth 483 milionë lekë më të ulta ose rreth 1.2 përqind më pak, rrjedhojë kjo e interesave të brendshme, të cilat rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më të ulta se një vit më parë dhe e interesave të jashtme që janë rreth 0.8 miliardë lekë më të larta.

### Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 arritën në rreth 33 miliardë lekë duke qënë rreth 1.3 miliardë lekë më pak se një vit më parë ose rreth 3.9 përqind më të ulta. Këto shpenzime në fund të 2011s arritën 2.5 përqind të PBB, nga rreth 2.8 përqind që ishin një vit më parë.


## Shpenzimet operative dhe të mirembajtjes janar – dhjetor në vite



## Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet për subvencione, në fund të vitit 2011, arrijnë në rreth 3.3 miliardë lekë, duke qënë rreth 234 milionë lekë më pak ose 6.6 përqind më të ulta krahasuar me një vit më parë. Sic është përmendur edhe më sipër, rreth 1.52 miliardë lekë janë përdorur nga fondi i kontigjences për ruajtjen e defiçitit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore. Subvencionet në vitin 2011 arrijnë në rreth 0.25 përqind të PBB-së, nga rreth 0.29 përqind që rezultuan një vit më parë.


## Shpenzimet për subvencione janar – dhjetor në vite



## Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet për fondet speciale gjatë vitit 2011, rezultojnë rreth 97.4 përqind të planit vjetor me ndryshime, ose rreth 7.2 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet për sigurimet shoqërore, krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë rreth 5.9 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.5 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.8 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.3 përqind më të larta. Deri në fund të vitit 2011, rreth 1.66 miliardë lekë, ose rreth 97.4 përqind e planit vjetor, janë përdorur për kompensimin në vlerë të pronarëve.


**Shpenzimet per Sigurimet Sociale Janar – dhjetor në vite:**



**Shpenzime të Pushtetit Lokal**

Shpenzimet për buxhetin lokal kanë arritur në rreth 28.1 miliardë lekë, duke rezultuar rreth 2.6 miliardë lekë më të ulta se një vit më parë ose rreth 8.6 përqind më pak. Këto shpenzime arritën në rreth 2.1 përqind të PBB-së nga rreth 2.5 përqind që rezultuan vitin e kaluar.

**Shpenzimet për pushtetin vendor janar – dhjetor në vite**




**Pagesa e Papunësisë**

Pagesa e papunësisë rezulton me një realizim prej rreth 93.2 përqind ose rreth 64 milionë lekë më pak se parashikimi vjetor, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 106 milionë lekë më pak ose rreth 10.8 përqind më pak se një vit më parë.

Ndihma ekonomike gjatë vitit 2011 arriti në rreth 16.4 miliardë lekë, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 337 milionë lekë më pak ose rreth 2.0 përqind më e ulët se një vit më parë

### Shpenzimet për mbrojtjen sociale janar- dhjetor në vite



### SHPENZIMET KAPITALE

Shpenzimet kapitale në fund të vitit 2011 janë realizuar në nivelin 93.0 përqind të planit vjetor me ndryshime, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth 5.3 miliardë lekë. Për rrjedhojë investimet në vitin 2011 arritën në rreth 5.4 përqind e PBB-së nga rreth 5.5 përqind që rezultuan një vit më parë.

Krahasuar me vitin e kaluar, investimet me financim të brendshëm rezultojnë rreth 5.5 miliardë lekë më të ulta ose rreth 11.9 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 7.0 miliardë lekë më të larta ose rreth 33.6 përqind më të larta. Për rrjedhojë investimet në total rezultojnë rreth 3.1 miliardë lekë më shumë ose rreth 4.5 përqind më të larta kundrejt vitit 2010. Struktura e investimeve faktike të vitit 2011 ishte rreth 58.2 përqind investime të brendshme dhe rreth 39.5 përqind investime të huaja (diferenca prej rreth 2.3 përqind përfaqëson shpenzimet faktike për shpronësimet).

### Shpenzimet kapitale janar – dhjetor në vite

